

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqipëria mbetet pa masa fiskale për naftën, akti Normativ i akcizës nuk është më në fuqi
ADRESA	https://tpz.al/shqiperia-mbetet-pa-masa-fiskale-per-naften-akti-normativ-i-akcizes-nuk-e-shte-me-ne-fuqi-i332933
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:16:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:09:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3991186e01b74f3035879173bea6fbdec1076a08170afce6ef22d45897030f9
TEKSTI	485b0f0e03f690c79cd386ef0a5536e4d8ac9f9398a32825d2c00add16b0b2f1
PAMJA	4a2da23816895fda86c9073ab3db2e02fb04ca0f3ebc01fe0bb1f5ec686a4647

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3a7e345a53f7fd0924c739a6a67c2f426ffb2b4d7656392b74d07b36911fd571
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3a7e345a53f7fd0924c739a6a67c2f426ffb2b4d7656392b74d07b36911fd571>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

20:03 Nis protesta e 107-të para Kryeministrit, protestuesit thirrje kundër klasës politike • 19:47 Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin dhe i

AKTUALITET, 14 SEPTEMBER 2026, 21:09

Shqipëria mbetet pa masa fiskale për naftën, akti Normativ i akcizës nuk është më në fuqi



TPZ



Prej fundjavës çmimet e karburanteve në tregun e pakicës kanë shënuar rritje nga 10 deri 14 lekë më shumë sesa çmimet e mëparshme.

Nafta në pikat e karburantit po tregtohet me çmim 229 lekë për litër apo 10 lekë më e shtrenjtë sesa më parë, ndërsa benzina 219 lekë për litër apo 14 lekë për litër më e shtrenjtë.

Por, teksa çmimi i naftës ka kapur rekorde të reja, në ndryshim nga vendet e tjera të rajonit, të cilat prej disa javësh kanë miratuar masa të reja fiskale për uljen e akcizës, Shqipëria nuk po ndërmerr asnjë masë të re për amortizimin e efekteve të rritjes së çmimeve. Madje nuk ka më në fuqi as Aktin Normativ që parashikonte uljen e kufizuar të akcizës.

Për shkak të rritjes së çmimeve, më 3 Prill qeveria miraton Akti Normativ për uljen e akcizës me 20% nëse çmimi i naftës me pakicë kalonte nivelin 220 lekë për litër dhe benzina 200 lekë për litër.

Por Ministria e Financave shpjegoi për Monitor se vendimarrja për aplikimin e uljes së akcizës lidhej me funksionimin dhe vendimin e Bordit. Pas stabilizimit të çmimeve prej disa javësh Bordi i Transparencës nuk funksionon.

Por edhe kur ishte në fuqi akti normativ, masa fiskale pati përdorim të kufizuar. Ministri i Financave Petrit Malaj më herët gjatë një seance plenare deklaroi se masa është përdorur vetëm 2 herë dhe efekti financiar llogaritet 37 mln lekë apo rreth 350 mijë euro.

Ndërkohë, Shqipëria vijon të ketë çmimet më të larta të karburanteve në rajon për shkak të barrës së lartë fiskale që zë gati 50% të çmimit dhe mungesës së masave fiskale. Sipas një tjetër analize të Monitor, nafta në Shqipëri pak ditë më parë rezultoi 30% më e shtrenjtë sesa mesatarja e rajonit, për shkak të barrës së lartë fiskale dhe mosmarrjes së masave fiskale, teksa shumë shtete të rajonit i rikthyen ato.

ide!

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternative

Nga Preç Zogaj

John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

Nga Thoma Gëllçi

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Po ashtu në të gjitha vendet e rajonit mbi çmimin bazë të naftës llogaritet vetëm akciza dhe TVSH. Në disa shtete të rajonit akciza është 2% më pak. Në Maqedoninë e Veriut TVSh është 18% për naftën dhe benzinën, por u ul në 10% gjatë periudhës së rritjes së çmimeve.

Në Kosovë gjithashtu zbatohet norma e TVSH-së 18%.

TVSH në Malin e Zi arrin 21%, por ky shtet naftën e ngarkon vetëm me 2 taksa TVSH dhe akcizë, e cila së fundmi është përgjysmuar si masë për amortizimin e çmimeve.

Në Serbi TVSH është 20% ndërsa akciza para nisjes së luftës arrinte 59.5 lekë për litër. Por menjëherë pas nisjes së konfliktit në Lindjen e Mesme, Serbia uli akcizën me 25%. Masa u riaktivizua edhe disa javë më parë.

Në Shqipëri përveç akcizës të lartë prej 39.4 lekë për litër, TVSh-së 20% dhe mungesës së masave fiskale, mbi çmimin e naftës aplikohet edhe dy taksa të tjera shtesë, që nuk aplikohen në vendet e rajonit. Taksa e qarkullimit me vlerë 27 lekë për litër dhe taksa e karbonit 3 lekë për litër.

Nafta kap rekorde të reja, Shqipëria pa masa mbrojtëse

Nafta në Shqipëri ka arritur në 229 lekë për litër, ndërsa benzina është ngjitur në 219 lekë, duke shënuar nivele të reja rekord dhe duke rritur presionin mbi konsumatorët dhe bizneset.

Sipas të dhënave të publikuara nga Monitor, rritja e çmimeve të karburanteve po ndodh ndërsa Shqipëria nuk ka ndërmarrë masa të reja për të zbutur ndikimin te qytetarët. Ndërkohë, mekanizmi i parashikuar për uljen e akcizës me 20% mbetet i kufizuar në zbatimin e tij.

Sipas skemës, ulja me 20% e akcizës aktivizohej kur nafta kalonte nivelin 220 lekë për litër dhe benzina 200 lekë për litër, por vendimmarrja për aplikimin e saj lidhej me funksionimin dhe vendimin e Bordit.

Të dhënat tregojnë se kjo masë është përdorur vetëm dy herë. Sipas Monitor, efekti në buxhet nga aplikimi i saj ka qenë rreth 37 milionë lekë, ndërsa mekanizmi nuk është kthyer në një instrument të qëndrueshëm për mbrojtjen e konsumatorëve nga rritja e çmimeve.

Niveli prej 229 lekësh për litër për naftën dhe 219 lekësh për benzinën shton shqetësimet edhe për kostot e transportit, prodhimit dhe shërbimeve, me efekt zinxhir në çmimet e mallrave dhe shërbimeve.

Në kushtet e rritjes së re të çmimeve, mbetet e hapur pyetja nëse mekanizmi i uljes së akcizës do të aktivizohet sërish apo nëse qeveria do të ndërmarrë masa të tjera për të zbutur koston e karburanteve për konsumatorët shqiptarë./monitor/

AKTUALITET / 14 September 2026, 20:08

**Inaugurimi i Konsullatës së
Nderit të Shqipërisë,
kryeministri Rama shkon në
Napoli**

AKTUALITET / 14 September 2026, 20:03

**Nis protesta e 107-të para
Kryeministrit, protestuesit
thirrje kundër klasës politike**

AKTUALITET / 14 September 2026, 19:47

Rama për pagat e gjyqtarëve:
Askush nuk e zëvendëson
Parlamentin dhe nuk mund ta
urdhërojë legjislativin

AKTUALITET / 14 September 2026, 19:40

Klube, mentorim dhe ndihmë
me detyrat, ja si do të
funksionojë programi 'Pas
shkolle' në 408 institucione
arsimore

AKTUALITET / 14 September 2026, 19:28

Partia Mundësia mbledh
strukturat për zgjedhjet lokale
2027/ Shehaj: Do të jemi në
çdo Këshill Bashkiak

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:49

Divjaka nuk tërhiqet,
kundërshton bashkimin me
Lushnjën. Relacioni gati për
Kuvendin

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:43

20 sulme kibernetike gjatë
këtij viti/ Kazia: Tentative për
dezinformim nga vende të
huaja

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:26

Diaspora4Innovation: Nga
ekspertiza e diasporës te
partneritetet afatgjata
Artikull Promocional

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:17

Alarmi për bombë në shkollën
"Edith Durham", Koçiu: Një
çmenduri e mirëfilltë
kriminale

AKTUALITET / 14 September 2026, 18:11

Butrinti shënon rekord
vizitorësh, të ardhurat rriten
me 218% krahasuar me 2023

AKTUALITET / 14 September 2026, 17:35

Kërcënimi me jetë i gazetarit
Osman Stafa, reagon Policia

AKTUALITET / 14 September 2026, 17:02

Pajisje wireless dhe alkool!
Kontroll blic me urdhër të
SPAK-ut në paraburgimin e
Bradasheshit

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:53

Miratohet në parim rritja e
pagave për gjyqtarët/
Komisioni i Ekonomisë kalon
draftin e propozuar nga PS

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:22

Fluturimet gjatë verës:
Shqipëria mes vendeve me
rritje të lartë të trafikut ajror

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:10

Kërcënohet me vdekje
gazetari Osman Stafa,
SafeJournalists: Autoritetet
shqiptare të nisin hetimet
urgjentisht

AKTUALITET / 14 September 2026, 16:00

VIDEO/ Gjergj Luca ironizon
Berishën nga Fieri: Sot edhe
unë jam demokrat, në krah të
Gaz Bardhit

AKTUALITET / 14 September 2026, 15:40

Më pak investime jashtë/
BSH: Rreth 80 milionë euro u
kanalizuan drejt bizneseve
dhe kompanive të huaja

AKTUALITET / 14 September 2026, 15:33

Vendimi i Apelit për Ilir
Metën, ish-presidenti nuk do
të qëndrojë më në "kafazin e
qelqtë"

AKTUALITET / 14 September 2026, 15:16

Pagat e magjistratëve, Blushi:
I garantoi Reforma në Drejtësi,
trajtimi financiar i përcaktuar
me ligj

AKTUALITET / 14 September 2026, 14:43

Qëlloi në bark protestuesin e
prangosur, Hita pezullon nga
detyra efektivin e
"Shqiponjave"

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.